



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura e -III-

**KOMISIONI PARLAMENTAR PËR BUJQËSI, PYLLTARI, ZHVILLIM
RURAL, MJEDIS DHE PLANIFIKIM HAPËSINOR**

Procesverbal Nr.8
nga mbledhja e mbajtur më **25.04.2008**
kryesuar nga **Lulzim Zeneli**-kryetar i komisionit
Mbledhja filloi në orën 11,00

Të pranishëm :

Lulzim Zeneli kryetar i Komisionit, Ibrahim Selmanaj, Berat Luzha, Selvie Halimi, Hestet Cakolli , Myrvete Pantina, Ali Lajçi, Kosara Nikolić, Elheme Hetemi, Zylfi Merxha.

Mungoi : Zef Morina

Nga Sekretaria e Kuvendit : Bajram Badivuku, Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu.

Pjesëmarrësit tjerë: Çausht Kabashi, Shefki Zeqiri, Kurtesh Sherifi etj nga MBPZHR si dhe vëzhguesi nga presidenca-Nexhat Shatri

RENDI I DITËS U MIRATUA PA VËREJTJE :

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Projektligji për Ushqimin,
3. Të ndryshme

Procesverbali

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua, njëherit kryetari përshëndeti të pranishmit.

Projektligji për Ushqimin

Kryesuesi **Lulzim Zeneli** në fillim elaboroi për procedurën rreth këtij projektligji në mandatin e dytë si në seanca plenare ashtu edhe në punën e dy komisioneve funksionale. Ai fillimisht kërkoi nga përfaqësuesit e MBPZHR një mendim e cila do të shërbente komisionit në procedurën e mëtejme, përfaqësuesi i së cilës (**Çaush Kabashi**) theksoi se kjo ministri nuk ka ndryshime rrënjësore rreth projektligjit në fjalë, por shtoi se poçes agjensioni mbetet në kuadër të zyrës së kryeministrit, lirisht mund të thuhet se Ministria e Bujqësisë nuk ekziston më.

Lulzim Zeneli konstatoi se sa i përket ministrisë çdo gjë e qartë është dhe ritheksoi disa probleme të trashëguara nga mandati i kaluar rreth shqyrtimit. **Shefki Zeqiri** reagoi duke potencuar problemin e cila tanimë është bërë pengesë gadi e pakalueshme, ajo është se janë shpallur dy komisione funksionale, përndryshe ai potencoi se vonesa rreth nxjerrjes së këtij ligji shkakton dëme të mëdha Kosovës. **Selvie Halimi** kërkoi vendimin politik të komisionit lidhur me këtë projektligj, ndërsa **Berat Luzha** kërkoi që të vendos Qeveria si të vazhdohet më tutje, ngase në mandatin e kaluar mendimi i kërkuar nga Qeveria prej dy komisioneve nuk është respektuar si duhet (Qeveria ka sugjeruar atëherë që agjensioni të mbetet pranë zyrës së kryeministrit), ndaj përfundoi me kërkesë konkrete : të pyetet zyra e kryeministrit ku duhet ky agjension me pas vendin.

Lulzim Zeneli shprehu habinë se si Ministria e Shëndetësisë, përkatësisht ish ministri, është shprehur në Kuvend :”gjëni ju zgjidhjen më të mirë”, ndërsa në anën tjetër kundërshtohen këto synime, ndaj një projektligj i nënshkruar nga kryeministri çfarë dileme në këtë rast mund të paraqet, sepse neni 36 (neni kontestues) i takon projektligjit të cilin e ka nënshkruar kryeministri, andaj “çka nuk është e çartë?”, përfundoi ai.

Selvie Halimi dhe **Berat Luzha** përkundër argumenteve të logjikshme të kryetarit, insistuan në vendim politik të komisionit ose qeveritarët të vendosin (ministri etj), ngase vetëm Qeveria mund ti drejtohet Kuvendit në këtë rast. Shkresa duhet ti drejtohet kryeministrit me afatin e përgjegjes, nëse nuk ka përgjigje atëherë komisioni vendos.

Myrvete Pantina, Eset Cakolli dhe **Elheme Hetemi** ishin për një angazhim më serioz të Qeverisë (kryeministrit) në këtë rast shumë të rëndësishëm për popullin e Kosovës. Elheme Hetemi tha se ky ligj do të ketë edhe ngarkesa buxhetore, ndaj më mirë është që kjo agjension të mbetet në kuadër të kryeministrit.

Këshilltari i Ministrisë të Bujqësisë Kurtesh Sherifi theksoi se qëndrimi i ministrit Idriz Vehapi është të arrihet marrëveshja me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Qeverinë, ngase kemi të bëjmë me interes nacional që nuk duhet vonuar.

Pasi që përfaqësuesit e MBPZHR u larguan nga mbledhja **Lulzim Zeneli** konstatoi se kërkesa e komisionit për kompromis drejtuar Qeverisë është e padrejtë, sepse kemi të bëjmë me dy shtylla të shtetit (të veçanta), Kuvendi nuk harton strategjinë e Qeverisë, ndaj shprehu keqardhje për stërzgjatje të panevojshme të procedurës.

Selvie Halimi : “pse Qeveria ka dërgua diçka që as vet nuk ja din fundin qysh e ka”.

Ali Lajçi shprehu pajtimin me kryetarin sepse ky projekt ka ardhë kështu në Kuvend e cila u miratua në parim dhe shtoi se Kuvendit nuk duhet ti interesoi çka mendon Qeveria ose Ministria, ngase projektligji është i tyre (i Qeverisë), ndaj konstatoi se ky komision nuk e ka fuqinë për të sjellë vendimin e vetë.

Kosara Nikoliq u pajtua me kërkesën për të kërkuar nga kryeministria me shkrim që të mirën vesh bashkërisht me dy ministrinë kompetente (MBPZHR dhe MSH).

Ibrahim Selmanaj pyeti përkrahësit e kryeministrit : si e zbaton kryeministria këtë ligj ?

Lulzim Zeneli në emër të komisionit përmbylli këtë pikë të rendit të ditës si vijon :

P Ë R F U N D I M

Komisioni për Bujqësi e Mjedis kërkon nga zyra e kryeministrit qëndrimin rreth nenit 36 të projektligjit për ushqimin se ku duhet të ketë vendin Agjensioni për ushqim, pranë zyrës së kryeministrit apo në ministrisë së bujqësisë.

Bajram Badivuku
Admin. i Komisionit,

Kryetari i Komisionit,
Lulzim Zeneli